



Nr. Prot. 265

Tiranë, më 22/7/29

**Kriteret dhe Proçedurat e Pranimit për Shtetas Shqiptarë  
në Programet e Studimit të Fakultetit të Mjekësisë,  
Raundi i parë, viti akademik 2024- 2025**

Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” ofron programin e studimit të integruara të studimit të ciklit të dytë në *Mjekësi*. Programi i studimit në Fakultetin e Mjekësisë zhvillohet në gjuhën angleze.

**I. Kuotat dhe kriteret e pranimit**

Kuotat në dispozicion të kandidatëve shtetas shqiptarë për raundin e parë janë:

Program i studimit	Kuota
Program i integruar i studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në <i>Mjekësi</i>	145

Kandidatët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- janë pajisur me Diplomë të shkollës së mesme;
- plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave VKM nr. 436, dt. 03.06.2020 i ndryshuar me VKM nr. 46 dt. 27.01.2021, sipas së cilit, nota mesatare për t’u pranuar në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në vitin akademik 2024 -2025, **duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se 6.5;**
- nuk mund të ndjekin njëkohësisht më shumë se një program studimi në të njëjtin vit akademik, në universite publike dhe/ose jopublike, shqiptare dhe/ose të huaja.

Përzgjedhja e kandidatëve në programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë bëhet nëpërmjet testimeve të pranimit, të cilat përfshijnë:

1. Testim me shkrim në Anglisht, mbi njohuritë në Shkencat Natyrore (bazuar në lëndët si Biologji, Kimi, Matematikë, Fizikë)	30 pikë
2. Testim me shkrim mbi njohuritë në Gjuhën Angleze	20 pikë
3. Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	30 pikë
<b>Totale</b>	<b>80 pikë</b>

Testimet e pranimit do të zhvillohen në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" Rr. “Dritan Hoxha”, Tiranë, Shqipëri, në datat e mëposhtme:

Program i studimit	Data	Ora
Program i integruar i studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në <i>Mjekësi</i>	21/08/2024	10:00



## II. Pjesëmarrja në testimin e pranimit

Për të aplikuar në raundin e parë, kandidatët duhet të përzgjedhin në portalin online U-Albania: <https://ualbania.arsimi.gov.al/> programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", në datat 30 korrik deri në 04 gusht 2024.

Për të marrë pjesë në teste, nga data 08 gusht 2024 deri 16 gusht 2024 ora 16: 30, kandidatët duhet të:

1. dërgojnë me e-mail në adresën elektronike: [info@unizkm.al](mailto:info@unizkm.al) kopjen e kartës së identitetit duke specifikuar atësinë dhe një nr. telefoni;
2. paguajnë tarifën e regjistrimit në testim prej 2.000 lekë si më poshtë:
  - pranë filialeve të Bankës Intesa SanPaolo në llogarinë<sup>1</sup> me këto të dhëna:  
Përfituesi: Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë (Universiteti Katolik)  
1. IBAN AL60208112040000030694935302 për pagesat në Euro;  
2. IBAN AL06208112040000030694935304 për pagesat në Lekë.
  - me kartë krediti online në portalin universitar në adresën elektronike:  
<https://admissions.unizkm.al/#/auth/signin>
  - pranë Zyrës së Pranimeve të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", e disponueshme nga e hëna në të premte, nga ora 08:00-16:30.

Pjesëmarrësit duhet të paraqiten pranë Sekretarisë Mësimore të paktën 30 minuta përpara fillimit të testimit përkatës dhe duhet të jenë të pajisur me një dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë). Gjatë Gjatë zhvillimit të testimit është i ndaluar përdorimi apo mbajtja e mjeteve elektronike të komunikimit (telefonë celularë, I-Phone, I-Pad, etj.). Në rast konstatimi, pjesëmarrësit do të përjashtohen menjëherë nga testimi.

Listat e renditjes së kandidatëve do të kryhen në bazë të rezultateve përfundimtare individuale, sipas renditjes së pikëve të fituara dhe do të publikohen në ambientet e Universitetit dhe në faqen zyrtare: [www.unizkm.al](http://www.unizkm.al) në datën 25 gusht 2024.

## III. Regjistrimi/matrikullimi

Në datat 30 gusht deri në 13 shtator 2024 të gjithë kandidatët që janë shpallur fitues në testimet e pranimit të raundit të parë duhet të regjistrohen pranë Sekretarisë Mësimore. Sipas Udhëzimit nr. 12 dt. 30.06.2023 dhe Urdhrit të përbashkët QSHA- RASH nr. 112, dt. 05. 07. 2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) kjo periudhë është e ndarë në 7 faza 48-orëshe (30- 31; 01- 02; 03- 04; 06- 07; 08- 09; 10- 11 e 12-

---

<sup>1</sup> Ju lutemi të specifikoni në Urdhërpagesë emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe programin e studimit për të cilin po kryeni pagesën. Ditën e testimit duhet të paraqisni kopje të mandat-pagesës duke qënë se koha e mbërritjes së pagesave është e kufizuar.





13). Kandidatit të shpallur fitues, i dërgohet një e-mail nga Sekretaria Mësimore ku i komunikohen dokumentet e nevojshme për regjistrim dhe afati 48 orësh i kandidatit. Kur kandidati është shpallur fitues, ai duhet të paraqitet pranë Sekretarisë Mësimore brenda afatit 48-orësh. Nëse kandidati nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit dhe Sekretaria Mësimore thërret automatikisht kandidatin tjetër. Këto faza vijojnë deri në plotësimin e kuotave dhe përfundojnë në datën **13 shtator 2024**. Nëse pas përfundimit të listës së renditjes, do të mbeten ende kuota të paplotësuara dhe nuk do të ketë kandidatë në pritje, do të rikthehen në garë kandidatet e shpallur fitues të cilët nuk janë paraqitur për regjistrim në fazat paraardhëse dhe nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Kandidatët fitues në një program studimi, të cilët nuk janë regjistruar sipas afateve të raundit të parë, humbasin të drejtën për t' u regjistruar në këtë raund, por kanë të drejtën që të plotësojnë formularin e aplikimit të raundit të dytë.

**Për t' u regjistruar, kandidatët e shpallur fitues duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë Mësimore personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre dokumentacionin e mëposhtëm:**

- Mandatpagesë nga Banka për shlyerjen e kështit të parë ose të kështit të plotë të tarifës vjetore<sup>2</sup> të studimit (Urdhërpagesa për t' u paraqitur në bankë shkarkohet nga portali studentit: [portal.unizkm.al](http://portal.unizkm.al), zëri "Tariffe");
- Kopje të njehsuar më origjinalin të diplomës së maturës shtetërore/ dëftesës së pjekurisë ose të një diplome studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehsuar nga QSHA, së bashku me certifikatën përkatëse të notave;
- Raport mjeko-ligjor që vërteton aftësinë për të ndjekur studimet;
- Vërtetim banimi;
- Certifikatë familjare;
- Fotokopje e një dokumenti identifikimi të vlefshëm (kartë identiteti ose pasaportë);
- Certifikata Ndërkombëtare e Njohurive Gjuhësore në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor" dhe në zbatim të dekreteve në fuqi (nëse kandidati ka detyrimin për ta dorëzuar);
- Dy fotografi, format dokumenti.

Gjithashtu pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen:

- Kërkesa e regjistrimit (kërkesa mund të shkarkohet edhe nga portali studentit: [portal.unizkm.al](http://portal.unizkm.al));
- Deklarata e paraqitur në Shtojcat nr.1 dhe nr. 2 të Udhëzimit nr. dt. 30.06.2023;
- Kontrata e regjistrimit;

#### **IV. Procesi i çregjistrimit**

Kandidati ka të drejtë të çregjistrohet vetëm **në datat 14- 15 shtator 2024**. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë Sekretarisë Mësimore duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse ky veprim nuk kryhet

---

<sup>2</sup> Në rastet kur kandidati plotëson kushtet e parashikuara në Rregulloren e Tarifave për përfitimin e bursës vjetore, detyrimi i tij do të jetë në përputhje me tarifën e mbetur



**UNIVERSITETI KATOLIK  
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË**

---

në këto data, ai nuk ka të drejtë ta ndryshojë programin e studimit për këtë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin U-Albania dhe pranë Sekretarisë Mësimore.

**Rektori**

**Prof. Leonardo Palombi**

